



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:273331

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05812606

KA.nr.95/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T. “BITI-COM”, me seli në Podujevë, Lupç i Poshtëm, përfaqësuar sipas autorizimit nga Hamdi Podvorica kundër të paditurës 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, të përfaqësuar sipas autorizimit nga Erëlehta Popaj dhe Arlinda Morina, dhe 2. Komuna e Prishtinës, përfaqësuar sipas autorizimit nga Blinera Osmani Avokate nga Shoqëria e Avokatëve Sejdiu & Qerkini, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. Psh. 523/18 të datës 15.05.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 15.04.2024, më datë 09.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit paditësi N.T. “ BITI-COM”, me seli në Podujevë, kundër të paditurës: 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, 2. Komuna e Prishtinës, me çka ka kërkuar që të aprovohet padia e paditësit, të anulohet Vendimi PSH nr.523/18 i datës 24.10.2018 si i kundërligjshëm, të kompensohet paditësi për fitimin e humbur në shumë prej 23,122.40 euro, të kompensohen shpenzimet e pjesëmarrjes ne tender që arrijnë vlerën prej 1,018.02 euro, te dyja se bashku ne vlerën prej 24,140.60 euro, duke llogaritur edhe kamatën prej 8 % te llogaritur ne vlerën e fitimit të humbur 23,122.40 euro, nga data 28.02. 2019 deri me 29.02 2024, në shumë prej 9,259.10 euro si dhe kamatën prej 8 % në shpenzimet e tenderimit në shume prej 442.09 euro, duke llogaritur prej datës 30.02. 2024 e deri ne ditën e pagesës, si dhe shpenzimet gjyqësore për përfaqësim te avokatit në seancën gjyqësorë të 01.08.2023, 12.09.2023, 03.11.2023 dhe ne seancën

15.04.2024 nga 270 euro, për secilën seance, gjithsej 1,080,00 euro; për përpilimin e padisë 160 euro; për ekspertizë financiare 300 euro, taksë gjyqësore 40 euro te paguar me datë 28 dhjetor 2018; 50 euro, taksës gjyqësore te paguar më datë 15.03.2021; 20 euro sigurim, gjithsej 1,650 euro, **si e pabazuar**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 26.11.2018, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi N.T. "BITI-COM", me seli në Podujevë, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 2794/18 kundër të paditurit 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, 2. Komuna e Prishtinës, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. PSH.nr. 137/18 të datës 15.05.2018 me propozim që të aprovohet padia e paditësit dhe të anulohet vendimi PSH nr.523/18 i datës 24.10.2018 si i kundërligjshëm, si dhe të kompenzohet paditësi për fitimin e humbur në shumë prej 23,122.40 euro, pasi sipas konstatimit në ekspertizë financiare paditësi N.T "Biti Com" ishte OE i përgjegjshëm me çmim me të ultë dhe i ka plotësuar te gjitha kushtet e kërkuara dhe se është dëmtuar ne shumen e cekur mënyre të kundërligjshëm. Gjithashtu kërkon kompensimin e shpenzimet e pjesëmarrjes ne tender që arrijnë vlerën prej 1,018.02 euro, te dyja se bashku ne vlerën prej 24,140.60 euro, duke llogaritur edhe kamatën prej 8 % te llogaritur ne vlerën e fitimit të humbur 23,122.40 euro nga data 28.02. 2019 deri me 29.02 2024 në shumë prej 9,259.10 euro si dhe kamatën prej 8 % në shpenzimet e tenderimit në shume prej 442.09 euro duke llogaritur prej datës 30.02. 2024 e deri ne ditën e pagesës, si dhe shpenzimet gjyqësore për përfaqësim te avokatit në seancën gjyqësorë të 01.08.2023, 12.09.2023, 03.11.2023 dhe ne seancën 15.04.2024 nga 270 euro, për secilën seance, gjithsej 1,080,00 euro; për përpilimin e padisë 160 euro; për ekspertizë financiare 300 euro, taksë gjyqësore 40 euro te paguar me datë 28 dhjetor 2018; 50 euro, taksës gjyqësore te paguar më datë 15.03.2021; 20 euro sigurim, gjithsej 1,650 euro. Ndërsa, deklaron se heq dorë

nga kompensimi i dëmit të shkaktuar në shumë prej 99,820.00 € ngase sipas ekspertizës nuk është konstatuar së është shkaktuar dëmi i pretenduar.

2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 95/22.
3. Seanca përgatitore u mbajt me datë 01.08.2023, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, Hamdi Potvorica avokat, me pjesëmarrje të përfaqësueses të autorizuar të paditurës OSHP sipas autorizimit Erëlehta Popaj, dhe me pjesëmarrje të përfaqësueses të autorizuar të paditurës AK Komuna e Prishtinës sipas autorizimit Blinera Osmani nga kompania Sejdiu & Qerkini.
4. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 12.09.2023 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, Hamdi Potvorica avokat, me pjesëmarrje të përfaqësueses të autorizuar të paditurës OSHP sipas autorizimit Erëlehta Popaj, dhe me pjesëmarrje të përfaqësueses të autorizuar të paditurës AK Komuna e Prishtinës sipas autorizimit Blinera Osmani nga kompania Sejdiu & Qerkini dhe më datë 15.04.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Hamdi Podvorica avokat, sipas autorizimit të datës 22.11.2018 dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur 1.OSHP Arlinda Morina, sipas autorizimit të datës 15.04.2024, dhe ne prani të Ekspertes Financiare V.M., ndërsa në mungesë të përfaqësuesit sipas autorizimit të paditurës 2. Komunës së Prishtinës, të ftuar në mënyrë të rregullt, ftesën për seancë së bashku me ekspertizën financiare të ekspertes e ka pranuar më datë 26.03.2024, ndërsa më datë 12.04.2024 e ka dorëzuar në gjykatë një parashtrësë, me të cilën ka propozuar që të shtyhet seanca me arsyetim se në orën 11 gjenden në seancë tek zyra 125. Gjykata konstatoj se parashtrësës nuk i'a ka bashkangjitur asnjë provë, as ftesë dhe as procesverbal, prandaj refuzoj propozimi për shtyerje të seancës si i pabazuar, dhe seanca u mbajt konform nenit 41 të LKA-së.

Pretendimet e paditësit

5. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Autoriteti Kontraktues- Komuna e Prishtinës, me

date 31.01. 2018, ka publikuar njoftimin për kontratë "Furnizim me drunjë dekorativ, ne hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës" me nr. 616-18-317-111. Në tender kanë marrë pjesë 6 operator ekonomik, ndër ta dhe OE tani paditës N.T. "Biti" Com. Kushtet parësor për fitimin e tenderit ishte ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë. Ndërsa kushte te tjera ishin: kërkesa e përshtatshmërisë parapare me dispozitën e nenit 65 të LPP-së, përshtatshmëria profesionale dhe kapaciteti teknik dhe profesional. Paditësi i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara sipas njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit dhe dy here është rekomanduar dhe është shpallur fitues nga autoriteti kontraktues. Deri te lidhja e kontratës nuk ka ardhur për shkak se NTP "Lulishtja Buçaj" ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues. Dy kërkesat për rishqyrtim janë refuzuar nga autoriteti kontraktues si të pabazuara. NTP "Lulishja Buçaj" kundër vendimeve te autoriteteve kontraktuese të lartcekura ka ushtruar ankese ne OSHP dhe OSHP-ja e ka aprovuar ankesën si te bazuar dhe e ka anuluar njoftim për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

6. Ka shtuar se në rivlerësim autoriteti kontraktues e rekomandon NT. Biti Com" për lidhjen e kontratës, pasi ka vepruar sipas rekomandimeve te OSHP-së, e cila kishte kërkuar sqarim lidhur me certifikatën fitosanitare, te cilën NT "Biti Com " e ka parashtruar pranë autoritetit kontraktues ne baze te se cilës u konstatua se është OE i përgjegjshëm dhe ka ofruar çmim më të ultë. Kundër vendimit te AK te datës 07.06.2018, NTP "Lulishtja Buça" ka ushtruar ankese ne OSHP, e cila pa baze ligjore e aprovon ankesën e ankuesit, e anulon vendimin e atakuar dhe lëndën e kthen ne rivlerësim. Duke vepruar sipas vendmit te OSHP-se, AK ka rekomanduar dhe ka shpallur fitues NTP " Lulishtja Buça" ne mënyrë te kundërligjshme, pasi fituesi ishte me çmim më të lartë për 26,00.00 euro, se NT "Biti Com", ne kundërshtim me dispozita e nenit 1, 6, 59, 60 dhe 69 të LPP-së, ne këtë mënyrë buxheti i Kosovës është dëmtuar mbi 26,000. 00 euro. I pa kënaqur me këtë vendim NT. "Biti Com" tani paditës ka parashtruar ankese në AK dhe OSHP, por ankesa është refuzuar si e pabazuar. Deklaron se Nga vendimit i kundërshtuar është i kundërligjshëm sepse janë shkelur dispozitat e nenit 1.1, 7,59,60, dhe 69 të LPP-së. I propozon gjykatës që të aprovohet padia e paditësit dhe të anulohet vendimi PSH nr.523/ 18 i datës 24.10.2018 si i kundërligjshëm dhe të kompenzohet paditësi për fitimin e humbur.

Kundërshtimet e të paditurës OSHP

7. Përfaqësuesi të paditurës së parë në përgjigje në padi sipas parashtresës së datës 27.12.2023, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave, respektivisht ofertës së tij nuk është bërë në mënyrë të drejt nga AK, kur ka pretenduar pretenduar se ky OE e plotëson kërkesën e AK-së tek kapaciteti teknik dhe profesional, sepse AK-ja ka kërkuar certifikatë fitosanitare, ndërsa OE N.T. “Biti-Com”, për këtë kërkesë si dëshmi ka ofruar një certifikatë fitosanitare të datës 27 Shkurt 2018 nga shteti i Holandës. Në certifikatë në pikën 8 gjendet hapësira ku shënohen: vetitë dalluese, numri dhe përshkrimi i pakos, emri i prodhimit dhe emri botanik i bimës. Ndërsa në pikën 9 të certifikatës, duhet shënuar sasia. Në këtë hapësirë produkti me numër rendor 0001, emri i produktit mban përshkrimin “ potting substrate”, që në shqip është “Substrat për vazo”, apo “Dhe për vazo”, Në këtë hapësirë nuk ka ndonjë produkt tjetër apo përshkrim tjetër të produktit. Në pikën 9 shënon sasia 4 paleta, andaj ky pretendim nuk qëndron. Paneli shqyrtues ka konstatuar se vlerësimi i ofertës së OE ankues është bërë në pajtim me nenin 59 të LPP-së, për faktin se dëshmia e ofertuar prej OE ankues nuk është konform kërkesës së AK-së, dhe me të drejtë i njëjtit operator ekonomik është shpallur i pa përgjegjshëm nga ana e AK-së.
8. Prandaj deklaron se paneli shqyrtues ka vlerësuar se OE ankues nuk është i përshtatshëm, në kuptim të nenit 51 të LPP-së. OE ankues ka ofruar edhe certifikata tjera fotosanitare, mirëpo këto certifikata nuk kanë qenë pjesë e ofertës origjinale të OE “Biti” Com dhe nuk mund të zëvendësohen me certifikatën e dorëzuar më dosje, para hapjes së ofertave. Paneli shqyrtues ka sqaruar se eksperti i prokurimit në raportin e ekspertizës gabimisht i është referuar pikës 10 të certifikatës në fjalë, sepse pika 10 e certifikatës vetëm jep informata se inspektimi dhe testet janë bërë konform procedurave të duhura zyrtare dhe nuk përmban informata se çfarë bime apo çfarë produkti i është nënshtruar këtij inspektimi. Kjo informatë është dhënë në pikën 8 të certifikatës. Vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë, është bërë në pajtim me nenin 59 të LPP-së dhe nuk shihet ndonjë diskriminim apo favorizim i OE-ve pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit. Sa i përket kërkesës së palës lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar, Ligji i prokurimit publik, në asnjë nen nuk e parasheh se OSHP-ja obligohet të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar. I ka propozuar gjykatës që të

refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i panelit shqyrtues i OSHP-së PSH.nr. 523/18 i datës 24.10.2018.

Kundërshtimet e të paditurës AK Komuna e Prishtinës

9. Përfaqësuesi i të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës, në përgjigje në padi dhe pretendimeve të dhëna gjatë seancave gjyqësore ka deklaruar se, qëndrojnë në tërësi pranë përgjigjes në padi 21.06.2023, duke ritheksuar faktin se të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës i mungon legjitimiteti real për të qenë palë në procedurë ashtu siç parashihet në 13 të LKA-së. Prandaj i propozon gjykatës që kërkesë padia e paditësit për të paditurinë dytë të hedhet poshtë si e pa lejuar, për shkak të mungesës së legjitimitetit real pasiv të Komunës së Prishtinës.

Provat e administruara

10. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Njoftimi për dhënie të kontratës me nr. prokurimit 616-18-317-1-1-1 i datës 31.01.2018, Njoftimi për dhënie të kontratës nr. prokurimit 616-18-317-1-1-1 i datës 27.03.2018 me të cilën OE “Biti Com” i është dhënë kontrata, Procesverbali i hapjes së tenderit, Letër standarde për tenderuesin e suksesshmen 27.03.2018 OE “Biti Com”, Vendim i Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës për pezullim të aktivitetit të prokurimit me datë 30.03.2018, Vendim i Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës për refuzimin e ankesës të OE “Buqaj” i datës 04.03.2018, Vendim i Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës i datës 11.04.2018, me të cilin pezullohet aktiviteti i prokurimit, Raporti i Ekspertit në lëndën 137/2018, Vendim i OSHP-së me nr. PSH.137/18 i datës 08.05.2018 me të cilën anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, Njoftimi për Anulim për dhënie të kontratës e datës 15.0.2018, Administrohen si provë në shkresat e lëndës Kërkesa për sqarim nga paditës e datës 25.05.2018, këtij njoftimi i janë të bashkangjitura provat:

Certifikata Fitosanitare nga shteti i Holandës e datës 28.02.2018 nr.PCNU149364325, Certifikata tjetër fitosanitare e datës 28.02.2018 nga Ministria e çështjeve ekonomike autoriteti për sigurinë e produkteve të ushqimit dhe konsumatorëve e Holandës, Certifikatë tjetër 10 maj 2018 po ashtu nga shteti i Holandës, Certifikatë Fitosanitare e datës 16.07.2018, Raporti mbi Inspektimin Fitosanitar kufitar, Njoftimi për dhënie të kontratës e datës 28.05.2018 për OE “Biti”, Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm 27.03.2018 OE Biti Com, Vendim i autoriteti kontraktues i datës 13.06.2018për

pezullimin e aktiviteti të prokurimit, Vendim i OSHP-së i datës 06.08.2018 për aprovim të ankesës së OE “Lulishtja Buqaj”, Njoftim për anulimin e dhënies së kontratës e datës 27.08.2018, Njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues me të cilën Lulishtja Buqaj shpërblehet me kontratë letër standarde për tenderuesin e suksesshëm për OE Lulishtja Buqaj, letër standarde për tenderuesin e pa suksesshëm e datës 28.05.2018 drejtuar OE “Biti Com”, Vendim i autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës me të cilin refuzohet kërkesa për rishqyrtim nga OE Biti Com, Vendim nga AK i datës 27.09.2018 për pezullim të aktivitetit të prokurimit, dëshmia e pagesës për ankesë në vlerë prej 998.20 euro dhe ankesa OE Biti Com e datës 27.09.2018, Raport i ekspertit shqyrtues I.H. i datës 11.10.2018, Vendim i OSHP-së i datës 24.10.2018 me të cilën refuzohet ankesa OE Biti Com dhe vërtetohet Njoftimi për dhënie të kontratës, Dokument administrativ i datës 04.07.2018, Kontrolli Fitosanitar Kufitar me numër të protokollit PIKF20397/2018, Faturë e datës 02.07.2018 me Nr.XKBIT, Faturë e dërgesave e datës 02.07.2018 me nr.AMS03687821, Raporti i ekspertit i dorëzuar nga Avokati i Paditësit me vulë protokollit i pranuar nga OSHP me nr. 255/18 i datës 25.07.2018 dhe Raporti i Ekspertit shqyrtues i dorëzuar nga Avokati i Paditësit me vulë protokollit i pranuar nga OSHP me nr. 137/18 i datës 27.04.2018, Dosja e tenderit me nr. prok 616/18 -317-1-1-1 e datës 30.01.2018 me të gjitha dokumentet dhe specifikimet e kërkuar në procedurën e prokurimit, Deklarata nën betim nga OE N.T BITI COM e datës 07.03.2018, të bashkangjitura kërkesat për konfidencialitet nga i njëjti OE, Formulari për dorëzimin e tenderit nga OE Biti Com, DUD, OE Biti Com është importues sipas përshkrimit të mallit në rubrikën 31 të këtij dokumenti, Certifikatë e kontrollit kufitarë sanitarë me nr.19/18 nr. protokollit PIKF/04329/2018 për importuesin Biti Com, sipas përshkrimit të mallit në të njëjtën, Certifikata Fitosanitare e lëshuar nga eksportuesi në Holandë me nr. PCNU 149372924 e datës 27.02.2018, Certifikata e origjinës me nr. Y20144623 e datës 27.02.2018, Deklaratë për origjinën e mallrave nga OE Biti Com e dorëzuar në procedurë të prokurimit, Polica e sigurimit të tenderit me nr.060011180006077, Ekspertiza financiare e datës 29.02.2024 nga ekspertja gjyqësore V.M.

Vlerësimi i provave

11. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

12. Me Njoftimin për dhënie të kontratës me nr. prokurimit 616-18-317-1-1-1 i datës 31.01.2018, AK Komuna e Prishtinës më datë 31.01.2018, ka shpallur njoftimin për kontratë me numër të prokurimit 616-18-317-1-1-1, me titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, vlera e parashikuar e kontratës, në shumë prej 150,000.00 euro, Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshire te gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen) 1. Furnizimi me fidanë: Catalpa bignonoides "Nana" Lartësia e drurit nga toka deri ne degëzimet e para të jetë min. 2,00 m, me kurorë te formuar deri ne 3,00 m lartësi. Trashësia e trungut nga toka e deri ne 1 m lartësi të jete 0 15 - 20 cm. Druri duhet te jete i kultivuar në vazo me dheun humusor dhe sistem rrënjore mire te zhvilluar. Fidanët duhet te jenë të zhvilluara ne vazo me madhësi prej 55 - 80 litra. Furnizuesi për fidanët duhet të dëshmojë me certifikate fitosanitare dhe dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE - se. 200 copë. 2. Furnizimi me fidanë: Tilia europaeapallida Lartësia e drurit nga toka deri ne degëzimet e para të jene min. 2,00 m, me kurorë te formuar deri ne 3,50 m lartësi. Trashësia e trungut nga toka e deri ne 1 m lartësi të jetë O 15 - 20 cm. Druri duhet te jete i kultivuar në vazo me dheun humusor dhe sistem rrënjore mire te zhvilluar. Fidanët duhet te jenë të zhvilluara ne vazo me madhësi prej 55 - 80 litra. Furnizuesi për fidanët duhet të dëshmojë me certifikate fitosanitare dhe dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE - se. 1000 cope. 3. Furnizimi me fidane: Platanus acerifolia Lartësia e drurit nga toka deri në degëzimet e para të jenë min. 2,00 m, me kurorë te formuar nga 2.3 m - 4.0 m lartësi. Trashësia e trungut nga toka e deri ne 1 m lartësi të jetë O 15 - 20 cm. Druri duhet te jete i kultivuar ne vazo me dheun humusor dhe sistem rrënjore mire te zhvilluar. Fidanët duhet te jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55 - 80 litra. Furnizuesi për fidanët e furnizuara duhet te dëshmojë me certifikate fitosanitare, Kriteret e dhënies Çmimi më i ulët dhe tenderi ekonomikisht më i favorshëm, afati i fundit për aplikim data 07.03.2018. Tek kushtet për pjesëmarrje, seksioni III (2.4), Kapacitetit teknik dhe profesional kërkohet: 1. Kerkesa per certifikate hidrosanitare, dëshmia e këkuar certifikata hidrosanitare, 2. Operatori ekonomik duhet të deklaroj vendin e origjinës se mallrave, dëshmia deklarata për origjinën e mallrave e nenshkuar dhe e vulosur nga OE.
13. Procesverbali i hapjes së tenderit, me datë 07.03.2018 titulli i kontratës “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, numri i tenderëve të

pranuar 6, vendi i hapjes Komuna e Prishtinës, Departamenti i Prokurimit, rezulton se paditësi ka ofruar me vlerë më të ulët 99820,00 në krahasim me tenderuesit e tjerë.

14. Njoftimi për dhënie të kontratës nr. prokurimit 616-18-317-1-1-1 i datës 27.03.2018 me të cilën OE Biti Com i është dhënë kontrata.
15. Me datë 04.03.2018, AK Komuna e Prishtinës e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rivlerësim të parashtruar nga OE “Buqaj” të datës 30.03.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të AK-së të datës 27.03.2018, dhe është vërtetuar vendimi i AK për dhënie të kontratës të publikuar më datë 30.03.2018, AK vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
16. Me datë 27.03.2018 Komuna e Prishtinës me Letër standarde për tenderuesin e suksesshmen e ka njoftuar OE-në N.T. “Biti’ Com se kanë dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët, si përgjigje ndaj njoftimit të kontratë për aktivitetin e prokurimit.
17. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës më datë 30.03.2018 ka marr vendim për pezullim të aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, kundër njoftimit për dhënie të kontratë të AK-së, të datës 27.03.2018.
18. Vendim i Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës i datës 11.04.2018, me të cilin pezullohet aktiviteti i prokurimit, AK Komuna e Prishtinës e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr, të brendshëm 616-18-007-111, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të AK-së të publikuar me datë 30.03.2018.
19. Nga Raporti i Ekspertit shqyrtues i dorëzuar nga Avokati i Paditësit me vulë protokolli i pranuar nga OSHP me nr. 137/18 i datës 27.04.2018, Eksperti shqyrtues, në raport ka vlerësuar se nuk qëndron pretendimi ankimor se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Certifikatën Fito-Sanitare, e cila nuk përputhet me kërkesat teknike dhe profesionale. OE

i rekomanduar ka ofruar certifikatën fito-sanitare nga Holanda në emër të OE “Biti” Com dhe si e tillë e plotëson kërkesën e AK, pasi që pika 10 e certifikatës e konfirmon se kjo certifikatë fito-sanitare, është konform natyrës së prokurimit. Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të dëshmoj në lidhje me certifikatën e origjinës së mallit dhe dudi doganor i cili kërkohet për drunjtë dekorativ, eksperti profesional vlerëson se ky pretendim ankimor nuk qëndron për faktin se këto dy dokumente nuk kanë qenë kërkesë në FDT, por autoriteti kontraktues këto dy dëshmi është i obliguar ti kërkoj gjatë fazës së furnizimit, përkatësisht gjatë implementimit të kontratës me OE-në. I ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

20. Vendim i OSHP-së me nr. PSH.137/18 i datës 08.05.2018 me të cilën anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, Paneli shqyrtues e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE NTP “Lulishtja Bucaj”, lidhur me aktivitetin e prokurimet me titull Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr, të brendshëm 616-18-007-111, iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës dhe ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës së AK-së, me arsyetim se për këtë aktivitet të prokurimit është kërkuar certifikata sanitare e prejardhjes së mallit nga BE, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatë fito-sanitare e cila është për dhe (substrat), dhe nuk e ka treguar prejardhjen se drunjtë janë me prejardhje nga BE, ndërsa ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me furnizim me drunjë dekorativ e jo furnizim me dhe.
21. Njoftimi për Anulim për dhënie të kontratës e datës 15.05.2018, me të cilin AK ka njoftuar OE-të për anulimin e dhënies së kontratës me titull Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. të brendshëm 616-18-007-111, më datë 15.05.2018, me arsyetim se një urdhër i lëshuar nga OSHP kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës.
22. Email me datë 25.05.2018 nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtinës dhe OE “Biti Com”, AK përmes email-it ka kërkuar sqarim nga OE: N.T. "BITI-COM" lidhur me certifikatën fitosanitare të dorëzuar në ofertë. OE “Biti Com” në përgjigje në email ka deklaruar se certifikata fitosanitare e dorëzuar jep detaje të hollësishme për prejardhjen e drunjeve të cilat janë nga Bashkimi Evropian. Ka deklaruar se sipas dosjes së tenderit, pas nënshkrimit të kontratës, blerësi është

i obliguar që të kërkojë nga shitësi certifikatën fitosanitare për artikujt e kërkuar në parametere pas furnizimit me drunjë.

23. Certifikata Fitosanitare nga shteti i Holandës e datës 28.02.2018 nr.PCNU149364325, emri dhe adresa e marrësit N.T BITI COM”, klasifikimi i bimëve që rriten në vazo, sipas emrit dhe numri i pakove , sasia e deklaruar 32 shporta, 5715 copë.
24. Certifikata fitosanitare e datës 28.02.2018 Nr. PCNU 134503952 nga Ministria e çështjeve ekonomike autoriteti për sigurinë e produkteve të ushqimit dhe konsumatorëve e Holandës, për produktin e bimëve që rriten në vazo, klasifikimi sipas emrit botanik dhe sasia.
25. Certifikatë fitosanitare e datës 10.05. 2017 Nr. EC/NL nga shteti i Holandës, për produktin e bimëve që rriten në vazo, klasifikimi sipas emrit botanik dhe sasia. sasia e deklaruar në total 7066 copë.
26. Certifikatë fitosanitare e datës 16.07.2018, për produktin e bimëve që rriten në vazo, klasifikimi sipas emrit botanik dhe sasia.
27. Raporti mbi inspektimin Fitosanitar kufitar, pika kufitare e hyrjes Durrës, data e inspektimit 19.06.2016, lloji i ngarkesës Lule të ndryshme Dekorative,, 490 copë, Origjina e ngarkesës Itali, vendi i tranzitimit Kosovë.
28. Njoftimi për dhënie të kontratës e datës 28.05.2018 për OE “Biti”, AK Komuna e Prishtinës ka njoftuar OE “Biti” Com për dhënie të kontratës me titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr, të brendshëm 616-18-007-111, data e dhënies së kontratës 28.05.2018, vlera e përgjithshme e kontratës 99,820.00 euro,
29. Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm 28.05.2018 OE Biti Com, Komuna e Prishtinës ka njoftuar OE-në N.T. “Biti” Com se kanë dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët, si përgjigje ndaj njoftimit të kontratës, për aktivitetin e prokurimit, ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

30. Vendimi i autoriteti kontraktues i datës 13.06.2018 për pezullimin e aktiviteti të prokurimit, AK e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr, të brendshëm 616-18-007-111, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së AK-së.
31. Raport i ekspertit i dorëzuar nga Avokati i Paditësit me datë 25.07.2018, eksperti shqyrtues i ka rekomanduar panelit shqyrtues që në bazë të rregullores së brendshme të OSHP-së nr.01/2017 neni 17 par.3 që ankesën e OE ankues NTP “Lulishtja Buçaj”, të refuzohet apo hedhet poshtë si e pa afatshme, ngase ankesa është e parashtruar me vonesë.
32. Vendim i OSHP-së PSH.255/18 i datës 06.08.2018 për aprovim të ankesës së OE “Lulishtja Buçaj”, Paneli Shqyrtues i OSHP-së e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE NTP “Lulishtja Buçaj”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. të brendshëm 616-18-007-111, të iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës, pasi e ka vlerësuar ankesën si të afatshme e ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës duke e kthyer lëndën në rivlerësim, me arsyetim se OE ankues ka kërkuar qasje në dokumente më datë 31.05.2018, menjëherë pas pranimit të njoftimit për dhënie të kontratës ndërsa përgjigjen nga zyrtari i prokurimit e ka pranuar se mund të kenë qasje më datë 04.06.2018, që i bie dita e fundit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim, pra OE ankues ka pasur qasje në dokumente më datë 04.06..2018 dhe menjëherë e ka përgatitur kërkesën dhe më datë 06.06.2018 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. AK në këtë aktivitet ë prokurimit nuk e ka respektuar nenin 10 npar.3 të LPP-së ku shkruan se AK i ofron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e aktivitetit të prokurimit, dhe me këtë veprim të AK OE ankues i është muhar e drejta që të përpiloj pretendime ankimore të sakta në mungesë të dhënave, dhe me këtë veprim të AK mund të kuptohet qëllimi i AK-së për favorizim të kompanisë së caktuar dhe diskriminim të kompanisë ankuese, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues përkitazi me certifikatën sanitare paneli shqyrtueses ka vendosur në vendimin PSH.nr. 137/18 të datës 15.05.2018, për këtë aktivitet të prokurimit është kërkuar certifikata sanitare e prejardhjes së mallit nga BE, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatë fito-sanitare e cila është për dhe (substrat), dhe nuk e ka treguar prejardhjen se drunjët janë me prejardhje nga BE, ndërsa ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me furnizim

me drunjë dekorativ e jo furnizim me dhe. AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së pasi që veprimet janë të shoqëruar me një shkallë të lartë të diskriminimit dhe të jo transparencës gjatë udhëheqjes së kësaj procedure.

33. Njoftim për anulimin e dhënies së kontratës e datës 27.08.2018, me te cilin AK më datë 27.08.2018 ka njoftuar OE-të për anulimin e dhënies së kontratës me titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr, të brendshëm 616-18-007-111, më datë 27.08.2018, me arsyetim se një urdhër i lëshuar nga OSHP kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës.
34. Njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues me të cilën Lulishtja Buqaj shpërblehet me kontratë letër standarde për tenderuesin e suksesshëm për OE Lulishtja Buqaj, AK Komuna e Prishtinës ka shpërblyer me kontratë N.T.P. “Lulishtja Buqaj”, në vlerë totale të ofertës 126,240.00 euro.
35. Letër standarde për tenderuesin e pa suksesshëm e datës 28.05.2018 drejtuar OE “Biti Com”, AK ka njoftuar N.T.P. “Lulishtja Buqaj”, se kanë dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët si përgjigje ndaj njoftimit të kontratës, dhe se i është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin e tyre.
36. Vendim i Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës me të cilin refuzohet kërkesa për rishqyrtim nga OE Biti Com, AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim e parashtruar nga OE N.T. “Biti Com”, më datë 13.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. Të prok. 616-18-007-111, dhe mbështet njoftimin për dhënie të kontratës.
37. Vendim nga AK i datës 27.09.2018 për pezullim të aktivitetit të prokurimit, AK Komuna e Prishtinës, ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” me nr. 616-18-317-1-1-1, dhe nr. të brendshëm 616-18-007-111, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të AK-së, të datës 11.09.2018,
38. Raport i ekspertit shqyrtues I.H. i datës 11.10.2018, ka deklaruar se AK-ja tek kapaciteti teknik dhe profesional ku AK-ja ka kërkuar certifikatë fitosanitare. Paneli shqyrtues konstaton se OE N.T. “Biti-com”, për këtë kërkesë si dëshmi ka ofruar një certifikatë

fitosanitare të datës 27 Shkurt 2018, nga shteti i Holandës. Në certifikatë në pikën 8 gjendet hapësira ku shënohen: vetitë dalluese, numri dhe përshkrimi i pakos, emri i prodhimit dhe emri botanik i bimës. Ndërsa në pikën 9 të certifikatës, duket shënuar sasia. Në këtë hapësirë produkti me numër rendor 0001, emri i produktit mban përshkrimin “ potting substrate”, që në shqip është “ Substrat për vazo”, apo “Dhe për vazo”, Në këtë hapësirë nuk ka ndonjë produkt tjetër apo përshkrim tjetër të produktit. Në pikën 9 shënon sasia 4 paleta. AK ka kërkuar certifikatë fitosanitare në një aktivitet të prokurimit për furnizim me drunj dekorativ, ndërsa OE në këtë rast lidhur me kapacitetin teknik ka ofruar si dëshmi certifikatë për Substrat apo dhevë për mbjellje në vazo, andaj në këtë gjendje faktike OE ankues është i përshtatshëm në kuptim të nenit 51 të LPP-së. OE ankues në ankesë gjithashtu potencon raportin e ekspertizës paraprake lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku eksperti në atë rast ka vlerësuar se certifikata e OE “ Biti Com”, e plotëson kërkesën e AK-së. Këtë konstatim eksperti në seancë për shqyrtim kryesor e bazon në pikën 10 të certifikatës në fjalë, por i është referuar gabimisht kësaj pike sepse pika 10 e certifikatës vetëm jep informata se inspektimi dhe testet janë bërë konform procedurave zyrtare dhe nuk përmban informata se çfarë bime apo çfarë produkti i është nënshtruar këtij inspektimi. Kjo informate është dhënë në pikën 8 të certifikatës. Eksperti i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE të refuzohet si e pa bazuar dhe njëkohësisht të vërtetohet si i bazuar vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

39. Vendim i OSHP-së PSH.nr. 523/18 i datës 24.10.2018 me të cilën refuzohet ankesa OE Biti Com dhe vërtetohet Njoftimi për dhënie të kontratës, Paneli Shqyrtues i OSHP-së e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e OE “Biti Com”, lidhur me aktivitetin e prokurimit titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. të brendshëm 616-18-007-111 duke e vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. të brendshëm 616-18-007-111, iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës, me arsyetim se AK-ja ka kërkuar certifikate fitosanitare, ndërsa OE N.T. “Biti-Com”, për këtë kërkesë si dëshmi ka ofruar një certifikatë fitosanitare të datës 27 Shkurt 2018 nga shteti i Holandës. Në certifikatë në pikën 8 gjendet hapësira ku shënohen: vetitë dalluese, numri dhe përshkrimi i pakos, emri i prodhimit dhe emri botanik i bimës. Ndërsa në pikën 9 të certifikatës, duket shënuar sasia. Në këtë hapësirë produkti me numër rendor 0001, emri i produktit mban përshkrimin “ potting substrate”, që në shqip është “ Substrat për

vazo”, apo “Dhe për vazo”, Në këtë hapësirë nuk ka ndonjë produkt tjetër apo përshkrim tjetër të produktit. Në pikën 9 shënon sasia 4 paleta, andaj ky pretendim nuk qëndron. Paneli shqyrtues ka konstatuar se vlerësimi i ofertës së OE ankues është bërë në pajtim me nenin 59 të LPP-së, për faktin se dëshmia e ofertuar prej OE ankues nuk është konform kërkesës së AK-së, dhe me të drejtë i njëjtit operator ekonomik është shpallur i pa përgjegjshëm nga ana e AK-së. AK ka kërkuar certifikatë fitosanitare në këtë aktivitet të prokurimit për furnizim me drunjë dekorativ, ndërsa OE ankues në këtë rast ka ofruar dëshmi për kapacitet teknik dhe profesional certifikate për substrat apo dhe për mbjellje në vazo, dhe ky pretendim është i pa bazuar, andaj OE ankues nuk është i përshtatshëm, në kuptim të nenit 51 të LPP-së. OE ankues ka ofruar edhe certifikata tjera foto sanitare, mirëpo këto certifikata nuk kanë qenë pjesë e ofertës origjinale të OE “Biti” Com dhe nuk mund të zëvendësohen me certifikatën e dorëzuar më dosje, para hapjes së ofertave. Paneli shqyrtues ka sqaruar se eksperti i prokurimit në raportin e ekspertizës gabimisht i është referuar pikës 10 të certifikatës në fjalë, sepse Pika 10 e certifikatës vetëm jep informata se inspektimi dhe testet janë bërë konform procedurave të duhura zyrtare dhe nuk përmban informata se çfarë bime apo çfarë produkti i është nënshtruar këtij inspektimi. Kjo informatë është dhënë në pikën 8 të certifikatës. Vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë, është bërë në pajtim me nenin 59 të LPP-së dhe nuk shihet ndonjë diskriminim apo favorizim i OE-ve pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

40. Kontrolli Fitosanitar Kufitar me numër të protokollit PIKF20397/2018, Importues N.T “Biti” Com, lloji i mallit bimë të tjera të gjalla, përfshirë rrënjët shartimet dhe kalemata, spore kërpudhash.
41. Raport i Ekspertit shqyrtues i datës 27.04.2018, Eksperti shqyrtues ka vlerësuar se nuk qëndron pretendimi ankimor se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Certifikatën Fito-Sanitare, e cila nuk përputhet me kërkesat teknike dhe profesionale. OE i rekomanduar ka ofruar certifikatën fito-sanitare nga Holanda në emër të OE “Biti” Com dhe si e tillë e plotëson kërkesën e AK, pasi që pika 10 e certifikatës e konfirmon se kjo certifikatë fito-sanitare, është konform natyrës së prokurimit. Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të dëshmojë në lidhje me certifikatën e origjinës së mallit dhe dudi doganor i cili kërkohet për drunjë dekorativ, eksperti profesional vlerëson se ky pretendim ankimor nuk qëndron për faktin se këto dy

dokumente nuk kanë qenë kërkesë në FDT, por autoriteti kontraktues këto dy dëshmi është i obliguar ti kërkoj gjatë fazës së furnizimit, përkatësisht gjatë implementimit të kontratës me OE-në. I ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

42. Deklarata nën betim nga OE N.T BITI COM e datës 07.03.2018, të bashkangjitura kërkesat për konfidencialitet nga i njëjti OE, N.T. “Biti Com” ka deklaruar nën betim se si OE është i përshtatshëm në përputhje me nenin 65 të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Sipas Formularit për dorëzimin e tenderit nga OE Biti Com DUD, OE Biti Com është importues sipas përshkrimit të mallit në rubrikën 31 të këtij dokumenti, OE “Biti Com” ka dorëzuar aplikimin për tender titulli i kontratës” Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me çmimin ofertues prej 99,320.00 euro.
43. Certifikata e kontrollit kufitarë sanitarë me nr.19/18 nr. protokoli PIKF/04329/2018 për importuesin Biti Com, sipas përshkrimit të mallit në të njëjtën, nga Certifikata Fitosanitare e lëshuar nga eksportuesi në Holandë me nr. PCNU 149372924 e datës 27.02.2018, Certifikata e origjinës me nr. Y20144623 e datës 27.02.2018, Deklaratë për origjinën e mallrave nga OE Biti Com e dorëzuar në procedurë të prokurimit, dhe Polica e sigurimit të tenderit me nr.060011180006077.
44. Ekspertiza financiare e datës 29.02.2024 nga ekspertja gjyqësore V.M., me të cilin ka konkluduar se fitimi i humbur nga mos realizimi i kontratës në tender për furnizim me drunje dekorativ në Komunen e Prishtinës, arrin vlerën 23,122.4 €, shpenzimet e pjesëmarrjes 1,018.2 €, të dyja në vlerë totale prej 9,701.19 €, dhe kamata e llogaritur deri me datë 29.02.2024 arrin vlerën prej 9,70.19 €.

Baza Ligjore

45. LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS Neni 6 përcakton Ekonomicitetin dhe Efikasiteti , paragrafi 1 parasheh se “Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”, paragrafi 2 parasheh “Fondet publike dhe burimet

publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës”, Neni 7 përcakton Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1 parasheh se “*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*”, paragrafi 2 parasheh se “*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik*”. Neni 28 përcakton Specifikimet teknike paragrafi 1 parasheh se “*Autoriteti kontraktues do ti parashtrorë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit*. Neni 52 përcakton Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës paragrafi 1 parasheh se “*Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret mund të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm*”. paragrafi 2 parasheh se “*Nëse autoriteti kontraktues ka specifikuar se kontrata publike do t’i shpërblehet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin ekonomikisht më të favorshëm, autoriteti kontraktues në fjalë duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriteret që do të merren parasysh gjatë vendosjes së fituesit dhe peshën që i është dhënë secilit kriter. Sa më shumë që është e mundshme, autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre*”

46. Neni 59 përcakton Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, paragrafi 1 përcakton se “*Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave*, paragrafi 2 përcakton “*Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues*”, paragrafi 3 përcakton “*Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t’i dërgojë të gjithë tenderueseve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla*”, paragrafi 4 “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e*

kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”, Neni 60 përcakton Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 përcakton se “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar”, 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji

Vlerësimi i gjykatës

47. Nga provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: më datë 31.01.2018 Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës, ka shpallur njoftimin për kontratë me numër të prokurimit 616-18-317-1-1-1, me titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, vlera e parashikuar e kontratës, në shumë prej 150,000.00 euro, për furnizim me fidanë: Catalpa bignonoides "Nana", Furnizimi me fidanë Tilia europaeapallida, Furnizimi me fidane: Platanus acerifolia, për secilën kategori këkohet që Furnizuesi për fidanët e furnizuara duhet të dëshmojë me certifikate fitosanitare. Kriteret e dhënies së kontratës janë përcaktuar: Çmimi më i ulët dhe tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ndërsa afati i fundit për aplikim ishte përcaktuar data 07.03.2018. Tek kushtet për pjesëmarrje, seksioni III (2.4), Kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar: 1. Kërkesa për certifikate hidrosanitare, dëshmia e këkuar certifikata hidrosanitare, 2. Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendin e origjinës së mallrave, dëshmia deklarata për origjinën e mallrave e nënshkruar dhe e vulosur nga OE.
48. Nga Procesverbali i hapjes së tenderit, me datë 07.03.2018 titulli i kontratës “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, numri i tenderëve të pranuar 6, vendi i hapjes Komuna e Prishtinës, Departamenti i Prokurimit, rezulton se paditësi ka ofruar me vlerë më të ulët 99820,00 në krahasim me tenderuesit e tjerë. Kështu që me datë 27.03.2018 OE “Biti Com” është njoftuar se i është dhënë kontrata me nr. prokurimit 616-18-317-1-1-1.

49. Ankesa e parashtruar nga OE “Buqaj” më datë 30.03.2018, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të AK-së, më datë 04.03.2018, është refuzuar nga AK Komuna e Prishtinës si e pa bazuar dhe është vërtetuar vendimi i AK për dhënie të kontratës të publikuar më datë 30.03.2018, AK vendos ka vazhduar me aktivitetin e prokurimit.
50. Ndaj vendimi të AK Komuna e Prishtinës, OE “Buqaj” ka parashtruar ankesë në OSHP, për çka Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës me datë 11.04.2018, e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, deri në vendimi e OSHP-së lidhur me ankesë.
51. Paneli shqyrtues i OSHP-së me Vendim nr. PSH.137/18 të datës 08.05.2018 me të cilën anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE NTP “Lulishtja Bucaj”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. të brendshëm 616-18-007-111, iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës dhe ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës së AK-së, me arsyetim se për këtë aktivitet të prokurimit është kërkuar certifikata sanitare e prejardhjes së mallit nga BE, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatë fito-sanitare e cila është për dhe (substrat), dhe nuk e ka treguar prejardhjen se drunjët janë me prejardhje nga BE, ndërsa ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me furnizim me drunjë dekorativ e jo furnizim me dhe.
52. Pas vendimit të OSHP-së, AK me datë 15.05.2018, ka njoftuar OE “Biti Com”, për anulimin e dhënies së kontratës me titull Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. të brendshëm 616-18-007-111, më datë 15.05.2018, me arsyetim se një urdhër i lëshuar nga OSHP kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës.
53. Gjykata konstaton se OE N.T. “Biti-com” në aplikimin fillestar, si dëshmi ka ofruar një certifikatë fitosanitare të datës 27 Shkurt 2018, nga shteti i Holandës, për produktin me numër rendor 0001, emri i produktit mban përshkrimin “potting substrate”/“Substrat për vazo”, apo “Dhe për vazo”, në kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit ku është kërkuar certifikatë fitosanitare për furnizim me drunjë dekorativ, për çka OE ankues ishte vlerësuar si i pa përshtatshëm në kuptim të nenit 51 të LPP-së.
54. Ndërsa pas vendimit të OSHP-së të datës 15.05.2018, me datë 25.05.2018 Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtinës përmes email-it ka kërkuar sqarim nga OE: N.T.

"BITI-COM" lidhur me certifikatën fitosanitare të dorëzuar në ofertë. OE "Biti Com" në përgjigje në email ka deklaruar se certifikata fitosanitare e dorëzuar jep detaje të hollësishme për prejardhjen e drunjeve të cilat janë nga Bashkimi Evropian. Ka deklaruar se sipas dosjes së tenderit, pas nënshkrimit të kontratës, blerësi është i obliguar që të kërkojë nga shitësi certifikatën fitosanitare për artikujt e kërkuar në parametere pas furnizimit me drunje. Ndërsa në email i ka bashkëngjitur certifikatat: 1. Certifikata Fitosanitare nga shteti i Holandës e datës 28.02.2018 nr.PCNU149364325, emri dhe adresa e marrësit N.T BITI COM", klasifikimi i bimëve që rriten në vazo, sipas emrit dhe numri i pakëve, sasia e deklaruar 32 shporta, 5715 copë. Në kategoritë e bimëve të listuara nuk janë përfshirë bimët e kërkuara sipas njoftimit për kontratë 1. Catalpa bignonioides "Nana"2. Tilia europaeapallida dhe 3. Platanus acerifolia. 2. Certifikata fitosanitare e datës 28.02.2018 Nr. PCNU 134503952 nga Ministria e çështjeve ekonomike autoriteti për sigurinë e produkteve të ushqimit dhe konsumatorëve e Holandës, për produktin e bimëve që rriten në vazo, klasifikimi sipas emrit botanik dhe sasia. Në kategoritë e bimëve të listuara nuk janë përfshirë bimët e kërkuara sipas njoftimit për kontratë 1. Catalpa bignonioides "Nana"2. Tilia europaeapallida dhe 3. Platanus acerifolia. 3. Certifikatë fitosanitare e datës 10.05. 2017 Nr. EC/NL nga shteti i Holandës, për produktin e bimëve që rriten në vazo, klasifikimi sipas emrit botanik dhe sasia. sasia e deklaruar në total 7066 copë, Në kategoritë e bimëve të listuara nuk janë përfshirë bimët e kërkuara sipas njoftimit për kontratë 1. Catalpa bignonioides "Nana"2. Tilia europaeapallida dhe 3. Platanus acerifolia. 4. Certifikatë fitosanitare e datës 16.07.2018, për produktin e bimëve që rriten në vazo, klasifikimi sipas emrit botanik dhe sasia. Në kategoritë e bimëve të listuara nuk janë përfshirë bimët e kërkuara sipas njoftimit për kontratë 1. Catalpa bignonioides "Nana"2. Tilia europaeapallida dhe 3. Platanus acerifolia. 5. Raport mbi inspektimin Fitosanitar kufitar, pika kufitare e hyrjes Durrës, data e inspektimit 19.06.2016, lloji i ngarkesës Lule të ndryshme Dekorative,, 490 copë, Origjina e ngarkesës Itali, vendi i tranzitimit Kosovë.

55. Pas dorëzimit të dokumenteve shtesë, me datë 28.05.2018 AK Komuna e Prishtinës sërish e ka zgjedhur OE "Biti Com" dhe të njëjtin e ka njoftuar për dhënie të kontratës me titull "Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës", me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. të brendshëm 616-18-007-111, data e dhënies së kontratës 28.05.2018, vlera e përgjithshme e kontratës 99,820.00 euro. Ndaj këtij njoftimi ka parashtruar ankesë NTP "Lulishtja Bucaj".

56. Me Vendim të OSHP-së PSH.255/18 i datës 06.08.2018 është aprovuar ankese e OE “Lulishtja Buqaj”, si e bazuar ankesën e OE NTP “Lulishtja Bucaj”, lënda është kthyer në rivlerësim, me arsyetim se AK nuk i ka ofruar qasje në dokumente OE ankues në kundërshtim me nenin 10 npar.3 të LPP-së ku AK obligohet ti ofron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e aktivitetit të prokurimit, dhe me këtë veprim të AK OE ankues i është muhar e drejta që të përpiloj pretendime ankimore të sakta në mungesë të dhënave, dhe me këtë veprim të AK mund të kuptohet se AK-së ka favorizuar një kompani dhe diskriminuar kompaninë ankuese, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.
57. Në procedurë të rivlerësimit AK Komuna e Prishtinës ka shpërblyer me kontratë N.T.P. “Lulishtja Buqaj”, në vlerë totale të ofertës 126,240.00 euro. Ndërsa, OE “Biti Com”, është shpallur si tenderues i pa suksesshëm. OE Biti Com, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, të cilën AK më datë 13.09.2018 e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për dhe ka lënë në fuqi njoftimin për dhënie të kontratës. Pas ankesës se OE “Biti Com”, në OSHP, AK me datë 27.09.2018 ka pezulluar aktivitetin e prokurimit.
58. Paneli Shqyrtues i OSHP-së me vendim PSH.nr. 523/18 i datës 24.10.2018 ka refuzuar ankesën e OE Biti Com dhe ka vërtetuar Njoftimi për dhënie të kontratës, sipas Raportit të ekspertit shqyrtues I.H. i datës 11.10.2018, Paneli shqyrtues ka konstatuar se tek kapaciteti teknik dhe profesional ku AK-ja ka kërkuar certifikatë fitosanitare, OE N.T. “Biti-com”, për këtë kërkesë si dëshmi ka ofruar një certifikatë fitosanitare të datës 27 Shkurt 2018, nga shteti i Holandës. Në certifikatë në pikën 8 gjendet hapësira ku shënohen: vetitë dalluese, numri dhe përshkrimi i pakos, emri i prodhimit dhe emri botanik i bimës. Ndërsa në pikën 9 të certifikatës, duket shënuar sasia. Në këtë hapësirë produkti me numër rendor 0001, emri i produktit mban përshkrimin “ potting substrate”, që në shqip është “ Substrat për vazo”, apo “Dhe për vazo”, Në këtë hapësirë nuk ka ndonjë produkt tjetër apo përshkrim tjetër të produktit. Në pikën 9 shënon sasia 4 paleta. AK ka kërkuar certifikatë fitosanitare në një aktivitet të prokurimit për furnizim me drunj dekorativ, ndërsa OE në këtë rast lidhur me kapacitetin teknik ka ofruar si dëshmi certifikatë për Substrat apo dhe për mbjellje në vazo, andaj ka vlerësuar se OE ankues është i pa përshtatshëm në kuptim të nenit 51 të LPP-së. Konstaton se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë, është bërë në

pajtim me nenin 59 të LPP-së dhe nuk shihet ndonjë diskriminim apo favorizim i OE-ve pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

59. Nga vendimi i kundërshtuar, Gjykata konstaton se OSHP në vlerësimin e përshtatshmerise teknike dhe profesionale të OE "Biti Com" e ka vlerësuar vetëm certifikatë fitosanitare të datës 27 Shkurt 2018, nga shteti i Holandës të dorëzuar në ofertë në momentin e aplikimit për kontratë nga OE "Biti-Com", dhe nuk janë vlerësuar fare certifikatat fitosanitare të dorëzuara nga OE "Biti-Com", me datë 25.05.2018 përmes emailës, në përgjigje në këkesën e Autoritetit Kontraktues, Komuna e Prishtinës për sqarim nga OE: N.T. "BITI-COM" lidhur me certifikatën fitosanitare të dorëzuar në ofertë, si: 1. Certifikata Fitosanitare nga shteti i Holandës e datës 28.02.2018 nr.PCNU149364325, emri dhe adresa e marrësit N.T BITI COM", klasifikimi i bimëve që rriten në vazo, sipas emrit dhe numri i pakove , sasia e deklaruar 32 shporta, 5715 copë. Në kategoritë e bimëve të listuara nuk janë përfshirë bimët e kërkuara sipas njoftimit për kontratë 1. Catalpa bignonoides "Nana"2. Tilia europaeapallida dhe 3. Platanus acerifolia. 2. Certifikata fitosanitare e datës 28.02.2018 Nr. PCNU 134503952 nga Ministria e çështjeve ekonomike autoriteti për sigurinë e produkteve të ushqimit dhe konsumatorëve e Holandës, për produktin e bimëve që rriten në vazo, klasifikimi sipas emrit botanik dhe sasia. Në kategoritë e bimëve të listuara nuk janë përfshirë bimët e kërkuara sipas njoftimit për kontratë 1. Catalpa bignonoides "Nana"2. Tilia europaeapallida dhe 3. Platanus acerifolia. 3. Certifikatë fitosanitare e datës 10.05. 2017 Nr. EC/NL nga shteti i Holandës, për produktin e bimëve që rriten në vazo, klasifikimi sipas emrit botanik dhe sasia. sasia e deklaruar në total 7066 copë, Në kategoritë e bimëve të listuara nuk janë përfshirë bimët e kërkuara sipas njoftimit për kontratë 1. Catalpa bignonoides "Nana"2. Tilia europaeapallida dhe 3. Platanus acerifolia. 4. Certifikatë fitosanitare e datës 16.07.2018, për produktin e bimëve që rriten në vazo, klasifikimi sipas emrit botanik dhe sasia. Në kategoritë e bimëve të listuara nuk janë përfshirë bimët e kërkuara sipas njoftimit për kontratë 1. Catalpa bignonoides "Nana"2. Tilia europaeapallida dhe 3. Platanus acerifolia. 5. Raport mbi inspektimin Fitosanitar kufitar, pika kufitare e hyrjes Durrës, data e inspektimit 19.06.2016, lloji i ngarkesës Lule të ndryshme Dekorative, 490 copë, Origjina e ngarkesës Itali, vendi i tranzitimit Kosovë. Këto certifikata gjykata i vlerëson se janë në përputhje me kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional ku AK-ja ka kërkuar certifikatë fitosanitare, dhe janë dëshmi me të cilat do të provohej përshtatshëria profesionale dhe teknike e paditësit.

60. Mirëpo, gjykata vlerëson se këto Certifikata fitosanitare, paditësi OE N.T. “Biti-com”, nuk i ka dorëzuar fillimisht në momenti e aplikimit, respektivisht të dorëzimit të ofertës por vetëm pas vendimit të OSHP-së të datës 15.05.2018, dhe pas kërkesës për sqarim me datë e datë 25.05.2018. Sipas dosjes së tenderit, në udhëzimet për tenderuesin, tek specifikacionet teknike të detyrueshme, në seksionin 3.1 OE detyrohet të paraqes dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar në kontratë, në seksionin 9.1 & 9.2 janë përcaktuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, Kërkesa për Certifikatë fitosanitare, dhe Deklarata për Origjinën e Mallrave, Ndërsa, në seksionin 6.4 janë përcaktuar dokumentet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë të cilat do të kërkohen të dorëzohen nga tenderuesi që AK ka ndërmend ti jap kontratën, para dhënjes së kontratës, ku janë përcaktuar në mënyrë taksative (a, b, c). Gjykata vlerëson se në këtë kategori të dëshmimeve që mund të dorëzohen edhe më tej para nënshkrimit të kontratës nuk janë specifikuar Certifikatat fitosanitare dhe Deklarata për Origjinën e Mallrave, prandaj rrjedhimisht këto dëshmi tenderuesi do të duhej ti paraqes me rastin e dorëzimit të tenderit.
61. Prandaj, gjykata vlerëson se veprimet e AK, me rastin e kërkesës për sqarim duke i mundësuar OE “Biti Com” ti dorëzoj dokumentacion shtesë që nuk i ka dorëzuar fillimisht në momentin e dorëzimit të ofertës, por vetëm pas vendimit të OSHP-së të datës 15.05.2018, dhe pas kërkesës për sqarim me datë e datë 25.05.2018, është në kundërshtim me Nenin 7 i LPP-se, ku përcaktohet Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1 parasheh se *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*, paragrafi 2 parasheh se *“Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik”*.
62. Neni 59 përcakton Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, paragrafi 1 përcakton se *“Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave*, paragrafi 2 përcakton *“Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi,*

vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”, paragrafi 3 përcakton “Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t’i dërgojë të gjithë tenderueseve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla”, paragrafi 4 “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

63. Ndërsa Gjykata vlerëson se në rastin konkret AK i ka tejkaluar kufijtë e pranimin të sqarimeve duke i mundësuar OE “Biti Com” që pas fazës së vlerësimit të dorëzoj dokumentet që janë kusht për vlerësimin e përshtatshmërisë profesionale e teknike për ta vlerësuar fillimisht një OE si të përgjegjshëm. Me këtë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të cituara më lart, për ti trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe për të vepruar në mënyrë transparente, sepse ky veprim në një mënyrë ka ndikuar në dëm të operatorëve të tjerë ekonomik e në të mirë të një operatori ekonomik.
64. Prandaj, Gjykata vlerëson se Vendim i OSHP-së PSH.nr. 523/18 i datës 24.10.2018 me të cilën refuzohet ankesa OE “Biti Com” dhe vërtetohet Njoftimi për dhënie të kontratës, është i drejtë dhe i ligjshëm. Paneli Shqyrtues i OSHP-së, ka vlerësuar drejtë se OE “Biti Com”, në aktivitetin e prokurimit titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. të brendshëm 616-18-007-111 me titull “Furnizimi me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr, të brendshëm 616-18-007-111, iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës, në vend të certifikate fitosanitare për fidanë, për këtë kërkesë

si dëshmi ka ofruar një certifikatë fitosanitare të datës 27 Shkurt 2018 nga shteti i Holandës për produktin “potting substrate”, që në shqip është “ Substrat për vazo”, apo “Dhe për vazo”, prandaj dëshmia e ofertuar prej OE ankues nuk është konform kërkesës së AK-së, dhe me të drejtë i njëjtit operator ekonomik është shpallur i pa përgjegjshëm nga ana e AK-së. Dhe se OE certifikatat e tjera foto sanitare, nuk kanë qenë pjesë e ofertës origjinale të OE “Biti” Com dhe nuk mund të zëvendësohen me certifikatën e dorëzuar më dosje, para hapjes së ofertave. Prandaj edhe Gjykata vlerëson se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë, është bërë në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

65. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzimet procedurale u bazua në nenin 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.95/22, datë 09.05.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:273331
Datë: 12.06.2024
Numri i dokumentit: 05812606